



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:231001

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06316851

C.nr.21/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.A. me vendbanim në V, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N. S., avokat me seli në P., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” të cilën e përfaqëson sipas autorizimit M. D., me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jo material, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 02.10.2024, mori dhe me datë 17.10.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.A. dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 21.11.2018, t’ia paguaj paditësit shumat si më poshtë:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbjet fizike (trupore), shumën prej 1,400.00 euro;
- Për frikën e përjetuar, shumën prej 1,100.00 euro.

Në emër të dëmit material:

- Për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë, shumën prej 147.00 euro dhe
- Për ushqim të përforcuar shumën prej 147.00 euro.
- Për shpenzimet e mjekimit shumën prej 281.70 euro.

Ashtu që shuma e tërësishme për të gjitha format e dëmit arrijnë vlerën prej 3,075.70 euro me kamatë ligjore prej 8% dhe atë për dëmin material duke llogaritur nga data 22.01.2019 (data e paraqitjes së padisë), kurse për dëmin jo material nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi (08.08.2024) si dhe DETYROHET e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj shumën në vlerë prej 818.40 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura ta kompensoj paditësin mbi shumat e gjykuara në dispozitivin I të këtij aktgjykimi dhe atë:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje fizike (trupore), shumën prej 2,600.00 euro;
- Për frikën e përjetuar, shumën prej 2,900.00 euro

Në emër të dëmit material:

- Për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë, shumën prej 153.00 euro;
- Për ushqim të përforcuar shumën prej 153.00 euro dhe
- Për rehabilitimin fizioterapeotik, shumën prej 500.00 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 6,306.00 euro si dhe shumën prej 135.00 euro në emër të shpenzimeve të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi me datë 22.01.2019, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, me objekt kontesti për kompensim të dëmit material dhe jo material për shkak të lëndimit në aksidentin e datës 21.11.2018, të shkaktuar nga i siguruari i të paditurës.

Pretendimet e palëve

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar përmes padisë dhe gjatë seancave ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e tij në tërësi si e bazuar. Ka theksuar se me datë 21.11.2018, rreth orës 11:55 në V. është shkaktuar aksidenti në mes veturës e cila drejtohej nga

N. A., në të cilën ishte edhe paditësi dhe veturës së të siguruarit të të paditurës M. S., nga i cili aksident kishte pësuar dëmtime trupore paditësi dhe përgjegjës për këtë aksident ishte i siguruari i të paditurës. Pas nxjerrjes së ekspertizës nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë, paditësi ka kërkuar nga gjykata që e paditura ta kompensoj paditësin në shumën e përgjithshme prej 9,381.70 euro dhe atë, për dhimbje fizike në shumën prej 4,000 euro, për frikën e përjetuar shumën prej 4,000 euro, për ndihmën nga personi i huaj shumën prej 300 euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 300 euro, në emër të rehabilitimit klimaterik shumën prej 500 euro dhe në emër të shpenzimeve të mjekimit shumën prej 281.70 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 12%. Në fjalën përfundimtare ka kërkuar që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si e bazuar për faktin se nuk është kontestuese baza juridike dhe se lartësia e kërkesëpadisë është në harmoni me praktikën gjyqësore.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: 104.00 euro në emër të përpilimit të padisë, 104.00 euro në emër të precizimit të padisë, 40.00 euro për taksën gjyqësore, 300.00 euro në emër të ekspertizës mjekësore të ortopedisë dhe psikiatrisë dhe për përfaqësim në tri seanca shumën prej 402.40 euro, në shumën e përgjithshme prej 953.40 euro.

E paditura në përgjigjen në padi dhe në seancën e datës 02.10.2024, ka theksuar se nuk është kontestuese baza e kërkesëpadisë por vetëm lartësia, ashtu që në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit mbi shumën prej 1,200 euro, e cila shumë i është dhënë si ofertë paditësit dhe e cila konsiderohet nga e paditura si shumë reale e kompensimit material dhe jo material për këtë aksident e po ashtu ka theksuar se gjykata nuk duhet t'ia njoh paditësit kamatën ligjore prej 12% sepse e paditura e ka trajtuar në afatin kohor kërkesën e paditësit për kompensim.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova: Raporti i aksidentit i datës 21.11.2018 i Policisë së Kosovës me nr. 2018-BR-827, Raportet mjekësore, Faturat lidhur me shpenzimet e mjekimit të datave: 21.11.2018, 23.11.2018 (tri fatura), 03.01.2018 (2 fatura) 05.01.2019 10.01.2019 dhe 14.01.2019, përgjigja e të paditurës lidhur me kërkesën për kompensim, e datës

15.01.2019 dhe Ekspertizën mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe e psikiatrisë e punuar nga Dr. S. D.-Ortoped dhe Dr. Sh. H.-psikiater.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, provave të propozuara si dhe përgjigjes në padi në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes palëve nuk ishte kontestuese se paditësi kishte pësuar lëndime trupore në aksidentin e datës 21.11.2018 dhe se përgjegjës i këtij aksidenti ishte i siguruari i të paditurës. (Për këtë arsye nuk do të elaborohen provat që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e shkaktimit të aksidentit dhe raportet mjekësore)

Kontestuese në mes palëve ishte vetëm lartësia e kërkesëpadisë.

Nga ekspertiza mjekësore, e përgatitur nga eksperti ortoped S. D. dhe eksperti psikiatër Sh. H. është theksuar se duke u bazuar në raportet mjekësore të shkresave të lëndës dhe ekzaminimi i drejtpërdrejtë i paditësit i datës 28.08.2024, është konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pasur ndrydhje dhe përdredhje të regjionit të kokës dhe qafës, ndrydhje të regjionit të gjoksit dhe të regjionit të shpinës.

Ky lëndim i paditësit sipas ekspertizës mjekësore të ortopedisë është vlerësuar si lëndim i lehtë trupor, ashtu që në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk ka pasur dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, por ka pasur dhimbje të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 72 orëve, dhimbje të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej tri (3) javësh dhe dhimbje të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 12 muajsh, e sidomos gjatë ngarkesave fizike si dhe pozitave të detyruara dhe ndryshimeve klimatike.

Sa i përket frikës së përjetuar në aksident, nga ana e ekspertit psikiatër është konstatuar se duke marrë parasysh shkresat e lëndës dhe konstatimeve të ekspertit ortoped, paditësi si pasagjer në veturë ka arritur ta sheh momentin e aksidentit, ashtu që ka përjetuar frikë primare në kohëzgjatje prej 1-2 sekonde, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej tre (3) orësh, për shkak se pas përplasjes, kur është këndellur dhe e ka kuptuar se çfarë ka ndodhur, i ka ndjerë dhimbjet nga lëndimet e marra dhe ka filluar ankthi, frika, dhe vuajtja shpirtërore, që ka zgjatur deri në

përfundim të trajtimit në Qendrën Emergjente, frikë sekondare të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej tri (3) javësh, që kishte zgjatur pas daljes nga klinika dhe vazhdimit të trajtimit në shtëpi për shkak të në këtë kohë i njëjti ka përjetuar ankth, pagjumësi, pakënaqësi dhe se ka qenë pa disponim, si dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët në kohëzgjatje edhe të tri javëve vijuese për shkak të ankthit të lehtë, anashkalimit të bisedave apo traumës që ka përjetuar në momentin e aksidentit.

Sipas ekspertizës mjekësore, është konstatuar ka qenë i nevojshëm përkujdesja e personit të tretë në kohëzgjatje prej tri (3) javësh në kuptim të ndihmës së aktiviteteve të përgjithshme jetësore siç janë higjiena, veshmbathja, ushqimi dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Po ashtu është konkluduar se për paditësen ka qenë i nevojshëm ushqimi i përforcuar, i pajisur me vitamina, minerale dhe proteina në kohëzgjatje prej tri (3) javësh, si dhe është konstatuar se ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në kohëzgjatje prej dy (2) javësh, kurse është konstatuar po ashtu se nuk ka pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor.

Nga Faturat lidhur me shpenzimet e mjekimit, të cilat sipas ekspertizës mjekësore të eksperteve S. D. dhe Sh. H., është konstatuar se kanë ndërlidhje me shpenzimet e mjekimit për lëndimet nga aksidenti, gjykata ka vërtetuar se paditësi me faturën e datës 21.11.2018 ka pasur shpenzime prej 30 euro, me tri faturat e datës 23.11.2018, ka pasur shpenzime prej 20.70 euro, nga faturat e datës 03.01.2018, ka pasur shpenzime prej 28.70 euro, nga fatura e datës 05.01.2019, ka pasur shpenzime prej 45.60 euro, nga fatura e datës 10.01.2019 vërtetohet se ka pasur shpenzime të mjekimit në shumën prej 6.70 euro dhe nga fatura e datës 14.01.2019 është vërtetuar se paditësi ka pasur shpenzime në shumën prej 150 euro, në shumën e përgjithshme prej 281.70 euro.

Sa i përket dëmit material që i është shkaktuar paditësit, me nenin 136,1 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD) është përcaktuar që *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, ndërsa me nenin 137 të këtij ligji është paraparë që *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*. Po ashtu me nenin 169.1 të LMD-së është paraparë që *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”*, dhe me paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar që *“Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla”*, ndërsa në nenin 174 të LMD-së, përcaktohet se *“Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit*

të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim”. Tutje edhe me nenin 179 par 1, të LMD-së është paraparë që “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”.

Ndërkaq përpos dëmit material, paditësi nga aksidenti i datës 21.11.2018 ka pasur edhe dëm jo material, konkretisht nga ekspertiza mjekësore është vërtetuar se ai si pasoj e lëndimeve të lehta trupore ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë pas aksidentit dhe për këto arsye, duke u bazuar në nenin 183 par 1, të LMD-së që përcakton se “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”, gjykata paditësit i’a ka njohur pjesërisht edhe kompensimin për dëmin jo material.

Vendimi lidhur me kërkesën për kompensimin për dhimbjet fizike

Pjesa aprovuese

Sipas precizimit të kërkesëpadsisë, së datës 17.09.2024, paditësi ka kërkuar që në emër të dhimbjeve fizike me të gjitha nivelet e intensitetit të tyre, të kompensohet në shumën prej 4,000 euro, ndërsa gjykata duke u bazuar në natyrën e lëndimit, i konstatuar me ekspertizë si lëndim i lehtë trupor, e në lidhshmëri me nenin 174 dhe 183 par 1, të LMD-së, të lart cituar e po ashtu në praktikën gjyqësore të ndërtuar me Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 41/2023, të datës 27.02.2023 (Tani e tutje Udhëzuesi i GJS-së), i cili udhëzues për këtë natyrë të lëndimit(lëndime të lehta trupore) e ka përcaktuar kompensimin deri në 2,000 euro, e ka vlerësuar si të arsyeshëm dhe real kompensimin për këtë kërkesë të paditësit, në shumën prej 1,400.00 euro.

Pjesa refuzuese

Gjykata dispozitivin II, të aktgjykimit është konsideruar si të pabazuar kërkesën për kompensim për këtë bazë edhe në shumën prej 2,600.00 euro, ngase sipas vlerësimit të gjykatës, duke marrë parasysh shkallën e lëndimeve dhe kohëzgjatjen e tyre vlera përtej shumës prej 1,400.00 euro do të ishte të ishte joroporcionale dhe e paarsyeshme, kjo në raport edhe me dëmin e shkaktuar dhe natyrën e lëndimeve, e kjo duke u bazuar në nenin 183 par 2 të LMD-së, sipas të cilit thuhet se *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Po ashtu shuma e kërkuar nga paditësi është edhe mbi shumat e vlerësuara me udhëzuesin e GjS-së (Deri në 2,000 euro)

Vendimi lidhur me kërkesën për kompensimin për frikën e përjetuar

Pjesa aprovuese

Sipas precizimit të kërkesëpadsisë, në emër të frikës së përjetuar paditësi ka kërkuar që të kompensohet në shumën prej 4,000.00 euro, ndërsa gjykata duke u bazuar në natyrën e lëndimit zgjatjen e lëndimeve dhe faktin se sipas ekspertit psikiatër, paditësi kishte frikë primare që kishte zgjatur vetëm 1-2 sekonda, si dhe frikë sekondare e cila kishte zgjatur deri edhe në gjashtë (6) javë pas aksidentit, me pasoja në pagjumësi, ankth e trauma të aksidentit, e duke u bazuar në nenin 174 dhe 183 par 1 të LMD-së, e ka konsideruar si kompensim real që në emër të frikës së përjetuar paditësi të kompensohet në shumën prej 1,100.00 euro. Ky vendim po ashtu është i bazuar edhe në praktikën gjyqësore të ndërtuar me Udhëzuesin e GJS-së, i cili udhëzues për frikën e përjetuar në rastet me lëndime të lehta trupore, e ka përcaktuar kompensimin deri në 2,000 euro.

Pjesa refuzuese

Gjykata me dispozitivin II, të aktgjykimit është konsideruar si të pabazuar kërkesën për kompensim për këtë bazë edhe në shumën prej 2,900.00 euro ngase sipas vlerësimit të gjykatës duke marrë parasysh shkallën e lëndimeve dhe kohëzgjatjen e frikës, vlera përtej shumës së aprovuar (1,100 euro) do të ishte të ishte joroporcionale dhe e paarsyeshme, vendim ky i bazuar duke u bazuar në nenin 183 par 2 të LMD-së dhe nga praktika e ndërtuar nga Udhëzuesi i GjS-së.

Vendimi lidhur me kërkesën për kompensimin për ndihmën e personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar

Paditësi ka kërkuar nga e paditura që në emër të ndihmës së personit të tretë, të kompensohet në shumën prej 300.00 euro, kjo duke u bazuar në ekspertizën mjekësore e cila ka konstatuar se të njëjtit i është nevojitur ndihma e personit të tretë në kohëzgjatje prej tre (3) javësh, kurse duke u mbështetur në këtë ekspertizë ka kërkuar kompensimin në shumën prej 300.00 euro edhe për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej tre (3) javësh pas aksidentit.

Duke u bazuar në ekspertizën mjekësore të administruar në këtë shqyrtim gjyqësor, sipas të cilës është konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për tre javë pas aksidentit për ndihmën e personit të tretë për veshmbathje, mbajtje të higjienës e po ashtu në këtë periudhë edhe për ushqim të përforcuar me proteina dhe vitamina, gjykata ka vendosur që t'i aprovoj pjesërisht edhe kompensimet për ndihmën e personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar pas aksidentit, kurse sa i përket lartësisë së kompensimit, gjykata është bazuar në nenin 323 të LPK-së, sipas të cilit përcaktohet që *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”*, ashtu që është konsideruar se kompensimi për personin e tretë të vlerësohet me nga shtatë (7) euro në ditë dhe atë për 21 ditë, në shumën e përgjithshme me nga 147.00 euro, e po ashtu e ka aprovuar pjesërisht edhe kërkesën për kompensim në emër të ushqimit të përforcuar, duke llogaritur shpenzime prej shtatë (7) euro në ditë, që për 21 ditë paditësi është kompensuar në shumën prej 147.00 euro edhe për këtë lloj të kompensimit, të cilat lartësi të kompensimit gjykata i ka konsideruar që në raport me natyrën e lëndimit dhe mënyrën e trajtimit të tij, janë reale dhe të arsyeshme.

Në anën tjetër, gjykata me dispozitivin II, të aktgjykimit e ka konsideruar si e pabazuar kërkesën e paditësit për kompensim në emër të ndihmës së personit të tretë edhe në shumën prej 153.00 euro dhe 153.00 euro të tjera në emër të ushqimit të përforcuar sepse ashtu siç u tha me lartë, me shumën e aprovuar për secilën prej këtyre bazave të kompensimit (147 euro për secilën) arrihet qëllimi i shumës së aprovuar, kurse shuma përtej pjesës së aprovuar do të ishte në kundërshtim me natyrën e kësaj kërkesë.

Vendimi lidhur me kërkesën për kompensimin për shpenzimet e mjekimit

Gjykata e ka aprovuar në tërësi kërkesën e paditësit për kompensimin në emër të shpenzimeve të mjekimit pas aksidentit, kjo duke u bazuar në nenin 179 par 1, të LMD-së, ku është paraparë që *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”*, ngase paditësi me provat-faturat lidhur me shpenzimet e mjekimit, të cilat sipas ekspertizës mjekësore të eksperteve S. D. dhe Sh. H., është konstatuar se kanë ndërlidhje me shpenzimet e mjekimit për lëndimet nga aksidenti, është vërtetuar se paditësi me faturën e datës 21.11.2018 ka pasur shpenzime prej 30 euro, me tri faturat e datës 23.11.2018, ka pasur shpenzime prej 20.70 euro, nga faturat e datës 03.01.2018, ka pasur shpenzime prej 28.70 euro, nga fatura e datës 05.01.2019, ka pasur shpenzime prej 45.60 euro, nga fatura e datës 10.01.2019 vërtetohet se ka pasur shpenzime të mjekimit në shumën prej 6.70 euro dhe nga fatura e datës 14.01.2019 është vërtetuar se paditësi ka pasur shpenzime në shumën prej 150 euro, në shumën e përgjithshme prej 281.70 euro, të cilën shumë i padituri detyrohet t’ia paguaj paditësit.

Vendimi lidhur me kërkesën për kompensimin për shpenzimet e rehabilitimit fizioterapeutik

Gjykata me dispozitivin II, të aktgjykimit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit edhe për kompensimin për shpenzimet e rehabilitimit fizioterapeutik sepse pavarësisht se me ekspertizën mjekësore është konstatuar se paditësi ka pasur nevojë që në dy javët e para pas aksidentit të ketë tretman fizioterapeutik, paditësi nuk ka ofruar asnjë provë (fatura) me të cilat do të dëshmohehin shpenzimet e bëra për një tretman të tillë. Prandaj gjykata duke u bazuar në nenin 7 par 1 dhe 319 par 1, këtë kërkesë të paditësit e refuzoi në tërësi si të pabazuar.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 265/2020 i datës 02.12.2020 paditësit i’a njohu edhe të drejtën në kamatë ligjore, në lartësi prej 8% në vit, ashtu që për dëmin material kamat vonesa ka filluar të rrjedh nga data 22.01.2019, si dita e paraqitjes së padisë, kurse për dëmin jo material kamata llogaritet nga momenti i nxjerrjes së këtij aktgjykimi (08.08.2024), për të dy këto, e deri në pagesën definitive. Paditësi llogaritjen e kamatës e ka kërkuar me 12% në vit dhe atë nga data 11.12.2018, si dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim tek e paditura e deri në pagesën definitive, mirëpo paditësit nuk i ka ofruar asnjë provë se kur e ka paraqitur kërkesën për kompensim por gjykatës i ka dorëzuar vetëm përgjigjen e të paditurës së datës 15.01.2019, çka për gjykatën dëshmon se e paditura i ka kthyer përgjigje paditësit, mirëpo nuk dihet se në çfarë afati i’a ka kthyer këtë përgjigje dhe në këto rrethana,

gjkata ka vendosur që për kompensimin e dëmit material kamata të llogaritet nga momenti i paraqitjes së padisë, kurse për dëmin jo material nga data e këtij aktgjykimi (17.10.2024).

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 449 të LPK-së e po ashtu nenit 452.2, të LPK-së sipas të cilit përcaktohet që *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, ashtu që e paditura detyrohet që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 818.40 euro. Paditësi ka kërkuar që të kompensohet edhe në shumën prej 135.00 euro për pjesëmarrje në seancën e datës 02.10.2024, mirëpo kjo shumë e shpenzimeve është refuzuar nga gjykata sepse caktimi i kësaj seance është bërë për shkak se përfaqësuesi i paditësit precizimin e padisë së përpiluar me datë 05.09.2024, i’a ka dorëzuar gjykatës me datë 17.09.2024, çka ka ndikuar që gjykata ta shtyj seancën e datës 17.09.2024 për datën 02.10.2024, në mënyrë që të merret vlerësimi i të paditurës për ndryshimin e padisë, ashtu siç është përcaktuar me nenin 285 par 5 të LPK-së. Përfaqësuesi i paditësit ekspertizën e ka pranuar me datë 05.09.2024 dhe pasi edhe precizimin e padisë konform kësaj ekspertize e ka përpiluar në ditën e njëjtë, ka pasur kohë të mjaftueshme që t’ia dorëzoj gjykatës, në mënyrë që gjykata t’ia dorëzoj të paditurës bashkë me ftesën për seancën e datës 17.09.2024, andaj nga këto arsye është refuzuar edhe kërkesa e paditësit për kompensimin për përfaqësim të seancës së datës 02.10.2024.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:231001, C.nr.21/2019, me datë 17.10.2024**

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.